



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.319/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me seli në Ferizaj, paraqitur kundër subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve për Kosovën (PDAK), me seli në Ferizaj për shkak të cenimit të drejtës së votës, për Zgjedhjet Lokale të dt.22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e palejuar ankesa ZL.Anr.319/2017 e datës 21.10.2017 e subjektit politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me seli në Ferizaj.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 21.10.2017 nga subjekti politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim PAI, me seli në Ferizaj, me të cilën pretendon se me datë 21.10.2017 në ditën e heshtjes zgjedhore , i moshuari Ragip Hasani nga fshati Dubravë i cili është i vetmuar në shtëpinë e tij ka deklaruar se i është marrë dokumenti identifikues, nga bashkëshortja e Kryetarit të subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve për Kosovën (PDAK) Danush Ademi, në mënyrë që personi në fjalë të mos mund të ushtroj të drejtën e tij për të votuar. Lidhur me këtë rast theksohet se është informuar edhe policia.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një CD nga vendi i ngjarjes.

Paneli, paraprakisht vlerësoj lejueshmërinë e ankesës konstatoj se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli me rastin e vlerësimit të lejueshmërisë së ankesës ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për tu shqyrtuar nga ana e PZAP-it, pasi që parashtruesi i ankesës paraprakisht është dashur ti drejtohet organeve të ndjekjes lidhur me rastin.

Mbi këtë bazë Paneli nuk u lëshua në vlerësimin e pretendimeve ankimore të parashtruesit të ankesës përkitazi me cenimin e të drejtës për të votuar që i është bërë personit të moshuar, për faktin se, e drejta për paraqitjen e ankesës është e kufizuar në bazë të dispozitës së nenit 115.1 të LPZ-së, ku përcaktohet: “PZAP është organ i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me ligj dhe rregullat zgjedhore” dhe në rastin konkret shkelja e pretenduar nuk ka të bëjë me procesin zgjedhor.

Paneli në kuptim të nenit 6.4 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Rregullës nr. 02/2015) dhe nenit 115.1 të LQP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Zl.Anr. 319/2017 më datën 22.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LQP-së